VENDIM
Nr.22, datë 6.5.2010

PËR RINOVIM LICENCE TË OPERATORIT
UJËSJELLËS KANALIZIME SHA GJIROKASTËR (QYTET)

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë.....", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e operatorit Ujësjellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër me:
Drejtues ligjor z. Dashmir Qeli
Drejtues teknik z. Donalt Hasani
2. Operatori Ujësjellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Gjirokastër, fshati Valare.
Kjo licencë është e vlefshme deri në datën 6.5.2014.

KRYETARI
Avni Dervishi